



РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА
REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT

Бр./Nr _____

_____г./в.



Në bazë të nenit 22 paragrafi 1 të Ligjit për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 12/19), neni 40 paragrafi 3 i Rregullores së punës së Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsioni, duke vepruar në rastin e formuar pas kërkesës së paraqitur nga parashtruesi i panjohur, Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit (në tekstin e mëtejme KSHPK), në seancën e 82-të të mbajtur më 14.02.2023 ka miratuar si në vijim.

VENDIM

Veprimi sipas denoncimit me numër 12-4003/1 të datës 12.10.2021, **NDËRPRITET**. KSHPK-ja përcaktoi se lënda nuk ka elemente për veprim të mëtutjeshëm kompetent. Lënda me numër 12-4003 të datës 2021 të mbyllet dhe të arkivohet.

Vendimi i këtill në formë të depersonalizuar të publikohet në ueb faqen e KSHPK-së në afat prej 5 (pes) ditëve nga dita e miratimit.

Arsyetim

Lënda me numër 12-4003/1 të datës 12.10.2021 është formuar në bazë të denoncimit të dorëzuar nga ///. Pretendimet e paraqitura në denoncim kanë të bëjnë me dyshime për punë jo të duhur të personave zyrtar - Pretendimet e paraqitura në denoncim kanë të bëjnë me dyshimet për punë të pakujdesshme të zyrtarëve – anëtarëve të Komisionit për vendosjen e kërkesave për denacionalizim me seli në Komunën Kisella Vodë – Shkup, pranë Ministrisë së Financave të RMV-së. Më konkretisht, thuhet se komisioni i lartpërmendur nuk ka miratuar d.m.th. ka marrë vendime të pasakta pas kërkesave të paraqitura për denacionalizim ///. KSHPK-së i kërkohet shqyrtimi i çështjes në përputhje me kompetencat e saj ligjore. Krahas kërkesës janë paraqitur edhe dëshmi.

Pas mbikëqyrjes së përmbajtjes së denoncimit dhe provave të paraqitura, KSHPK kërkon veprim kompetent nga ana e komisionit të lartpërmendur si dhe nga Komuna e ----- dhe nga mbikëqyrja rezulton si vijim:

Në lidhje me lëndën ///, janë miratuar dy vendime nga ///. Ndaj të dyve është ngritur kontest administrativ në Gjykatën Administrative të RMV-së nga ana e parashtruesit.

Në lidhje me lëndën/// është kërkuar dokumentacion nga institucionet kompetente dhe për momentin ky rast po trajtohet nga komisioni i lartpërmendur.

Në lidhje me lëndën ///, u miratua një vendim ///, i plotfuqishëm në vitin ///. Pas këtij vendimi, për kërkuesit janë marrë vendime individuale, me të cilat do t'u paguhet kompensimi në bazë të shkombëtarizimit në formën e obligacioneve. Kundër vendimeve individuale, paditësit kanë paraqitur kontest administrativ në Gjykatën Administrative të RMV-së.

Në lidhje me lëndën /// u miratua një vendim ///. Kundër të njëjtit është parashtruar kontest administrativ në Gjykatën Administrative të RMV-së nga parashtruesit.

Në lidhje me lëndën ///, u miratua një vendim ///, i cili përmban udhëzime për mjet juridik pranë Gjykatës Administrative të RMV-së, në afat prej 30 ditësh, të numëruara nga dita e dorëzimit.

Duke qenë se komisioni i lartpërmendur ka vepruar me kërkesë të KSHPK-së, për marrjen e masave dhe veprimeve në lidhje me pretendimet nga denoncimi, dhe njëkohësisht duke vlerësuar faktin se ndaj vendimeve të sipërpërmendura po zhvillohen mosmarrëveshje administrative, KSHPK-ja vlerëson se çështja nuk ka elemente për veprime të mëtejshme. Organi kompetent i cili me ligj është i autorizuar për shqyrtimin e pretendimeve nga denoncimi është Gjykata Administrative e RMV-së, për të cilën parashtruesit e kërkesës kanë ngritur padi për të kontestuar ligjshmërinë e vendimeve të marra me të cilat kanë vendosur për kërkesat për denacionalizimin e parashtruesve të denoncimit.

Sipas sa më sipër KSHPK-ja vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Dorëzuar deri:
- autorizuesin e parashtruesit

Përgatiti: Mr. D.D
Miratoi: Mr. SH.S

**KOMISIONI SHTETËROР
PËR PARANDALIMIN E KORRUPTIONIT**
Nënkryetare,
Katica Nikolovska